



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I DËGJIMIT PUBLIK NGA KOMISIONI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR EKONOMI, INDUSTRI, NDËRMARRËSI DHE TREGTI,
MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2024**

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA ZA
EKONOMIJU, INDUSTRIJU, PREDUZETNIŠTVO I TRGOVINU,
ODRŽANE 28. JUNA 2024. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2024**

Dëgjimin publik e drejtoi kryesuesja e Grupit punues, znj. Jeta Statovci.

KRYESUESJA: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Ju dëshiroj mirëseardhje në këtë dëgjim publik. Konstatojmë se janë plotësuar kushtet dhe ata të cilët kanë konfirmuar pjesëmarrjen tashmë janë këtu përfshirë edhe deputetët e grupit punues.

1. Projektligji nr.08/L-279 për Inspektoratin qendror të mbikëqyrjes së tregut

Atëherë, e shpallim të hapur këtë dëgjim publik, në bazë të nenit 39 dhe nenit 38 të Rregullores së Kuvendit, komisioni mund të organizojë seancë dëgjimore për projektligjet, të cilat janë në procedurë të shqyrtimit me përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe qytetarë të interesuar. Dëgjimi publik legjislativ organizohet për mbledhjen e informacioneve, vërejtjeve dhe rekomandimeve për projektligjet dhe çështjet e tjera, të cilat janë në procedurë të shqyrtimit nga ky komision.

Në frymën e kësaj dispozite, si dhe duke marrë parasysh që si Parlament dhe si komision parlamentar jemi të hapur dhe transparent për çështjet që i shqyrtojmë, si kryesuese e grupit punues kam caktuar këtë dëgjim publik për Projektligjin për Inspektoratin qendror të mbikëqyrjes së tregut dhe tani jemi në fazën para se grupi punues të shqyrtojë nen për nen projektligjin. Prandaj, jemi të interesuar që të marrim nga ju të nderuar pjesëmarrës opinionet dhe propozimet e juaja lidhur me këtë projektligj.

Në këtë projektligj do të rregullohet veprimtaria e Inspektoratit Qendror për mbikëqyrje të tregut, si dhe përcakton organizimin dhe kompetencat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në territorin e Republikës së Kosovës. projektligji përcakton se IQMT-ja është institucioni i vetëm përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut përmes inspektimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë ligj dhe aktet tjera juridike në fuqi. Tani ua kalojmë fjalën pjesëmarrësve që t'i paraqesin opinionet e juaja për këtë projektligj, si dhe propozime nëse keni.

Si informatë teknike, ju lus që secili kur të merrni fjalën të prezantoheni dhe të tregoni institucionin apo organizatën të cilën e përfaqësoni. Pastaj, në bazë dhe të diskutimeve dhe komenteve ne mund të caktojmë edhe një datë të përbashkët për të dërguar propozimet ose amendamentet deri në një datë ku pastaj komisioni dhe grupi punues mbledhet për t'i shqyrtuar secilin një nga një.

Si datë propozuese pra mund të jetë data 05.07., pra data e fundit në të cilën ne i përcjellim edhe me shkrim palët e interesit, komentet, propozimet, sugjerimet që i kanë me këtë projektligj. Atëherë, pas përmbylljes së kësaj fjale hyrëse ua kaloj fjalën palëve të cilët dëshirojnë që të

marrin fjalën dhe të japin perspektivën e tyre në raport me këtë projektligj dhe për këtë mbledhje dhe këtë dëgjim publik që kemi sot. Faleminderit!

Nëse ka të interesuar, atëherë fjala për ju. Mundësisht të prezantoheni dhe tregoni institucionin.

NAIM HAJRA: Naim Hajra, prej Inspektoratit Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, në qoftë se na lejohet kryesuese si fillim me dhënë si me thënë një pasqyrë të shkurtë të projektligjit nga perspektiva jonë në mënyrë që pastaj me rrjedhë edhe diskutimi.

KRYESUESJA: Patjetër!

NAIM HAJRA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të shoqërisë civile,

Kolegë,

Gjithë ju të interesuar,

Faleminderit për mundësinë që sot para jush me i paraqit opinionet tona dhe me i dhënë arsyetimet tona mbi këtë projektligj.

Sikurse që e dini hartimi i këtij projektligji ka për qëllim që të rregullojë veprimtarinë e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, si dhe të përcaktojë organizimin dhe kompetencat e mbikëqyrjes së tregut në tërë territorin e Republikës së Kosovës. sikurse e dini në vitin 2022 ka hy në fuqi Ligji për inspektimet i cili ligj e ka afektu edhe organizimin e Inspektoratit të Tregut dhe i cili ligj ka synuar që me bë një reformë të inspektimeve. Ju e dini janë reduktuar numri i inspektorateve e kështu me radhë, prandaj një ndër qëllimet bazike të këtij projektligji është edhe harmonizimi i tij me Ligjin për inspektimet. Ne mendojmë që me miratimin e këtij ligji krijohet një bazë ligjore funksionale dhe lehtë e implementueshme për funksionalizimin e Inspektoratit të Tregut, meqë në të kaluarën Inspektorati i Tregut ka pas disa paqartësi në organizim dhe në formën se si ka vepruar për shkak të disa problemeve në zbatueshmërinë e ligjit paraprak që ka qenë, prandaj mendojmë që ky projektligj i eliminon këto paqartësi dhe krijon një bazë të mirë që Inspektorati i Tregut me qenë shumë funksional.

Me këtë projektligj është përcaktuar që IQMT-ja ka përgjegjësi inspektimin e standardeve dhe kërkesave ligjore të tregtimit të mallrave dhe të shërbimeve që i ofrojnë subjektet ekonomike, gjegjësisht bizneset në tërë territorin e Kosovës duke mbikëqyrë përmbushjen e kërkesave mandatore para dhe pas vendosjes së produkteve në treg, standardet e tregtimit të këtyre produkteve, sigurinë e produkteve në treg, mbrojtjen e konsumatorëve, produktin nga metalet e çmuara, mbikëqyrjen metrologjike, mbikëqyrjen e produkteve të naftës, kontrollin e produkteve të duhanit, veprimtaritë turistike dhe hotelerie, veprimtari zejtare, mbrojtjen e të drejtave të

pronësisë industriale në treg, e kështu me radhë, domethënë shumë aktivitete tjera të cilat i kryen ky institucion.

Prandaj, për aq sa e kemi pa ne jemi të gatshëm me i dhënë opinionet tona për secilin shqetësim që paraqitet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit për ndarjen e këtyre informatave dhe me pjesën tjetër të pranishmëve në këtë dëgjim publik, edhe pse sot në një numër më të limituar. Në qoftë se është dikush tjetër që dëshiron me marrë fjalën? Pra, sot jemi mbledhur parimisht të ju dëgjojmë juve sepse ne i bëjmë edhe diskutimet tona, mirëpo të marrim edhe perspektivën e juaj. Po, urdhëro!

ARSIM MORINA: Përshëndetje kryesuese!

Përshëndes deputetët,

I përshëndes kolegët, shoqëritë civile,

Unë quhem Arsim Morina, jam inspektor tregu nga Komuna e Malishevës. Fillimisht ju përshëndes, i përshëndes deputetët e nderuar, juve si kryesuese, shoqërinë civile, të odës ekonomike, kolegët inspektorë të komunave të ndryshme.

Unë mendoj që Ligji për mbikëqyrjen ose rregullimin e Inspektoratit të Tregut është i mirë shkruar, mirëpo për tu zbatuar ose për praktikë ka pengesa të shumta. Për shembull, duhet me u ballafaqua, për shembull rastet konkrete ne e kemi nga përvoja e inspektorëve që kanë kaluar te inspektorët sanitarë, tash për shembull inspektori sanitar i regjionit vjen një herë në javë në komunë ose në dhjetë ditë edhe vetëm atë qendrën. Do të thotë, ka vetëm një kontroll aty për aty, vetëm ato lokacione, ndërsa komuna ... është e përfshirë për 44 fshatra, do të thotë secili fshat ka biznese që zhvillohen. Do të thotë, nuk ka kohë nuk mundet me arrit për shembull ai me shkua me i kontrollua të gjithë.

Plus tjetra, këto pëlqimet sanitare që jepen, edhe tash pëlqimet teknike prej inspektorit të tregut do të thotë nuk i pranojmë në mënyrë elektronike, por secili pronar i biznesit duhet me shkua me bë kërkesën në Prizren, vjen inspektori brenda javës, dhjetë dite, ia bën licencimin, bën kontrollin, rapë duhet me shkua me marrë licencën në Prizren.

Dhe, kjo është e mundimshme. Ose ne si inspektorë të tregut tash për shembull nëse kalohet regjioni ne që i takojmë për shembull Prizrenit, ne duhet me u shkua prej fshatit me ardh edhe një herë në qytet, prej qytetit me shkua me udhëtua në regjion atje në Prizren. Nuk jam kundër ligjit, ligjet janë shumë të mira, mirëpo duhet me pa edhe zbatimin e tyre në praktikë për të na krijuar kushte sa më të mira.

Unë më tepër kisha kërkuar që të rritet numri i inspektorëve se sa për shembull të bëhet tërheqja e inspektorëve komunal, për shembull në nivelin qendror, kështu që inspektorët e tregut niveli

qendror vijnë një herë në javë, ndërsa bizneset kanë nevojë me inspektua thujse çdo ditë. Kështu që unë prapë jam me shumicën, mirëpo ka vështirësi. Ne do të ballafaqohemi, ne jemi ata që duhet të ballafaqohemi çdo ditë për të implementuar këtë ligj.

KRYESUESJA: Faleminderit për komentet e juaja. besoj që nuk pati diçka të bëjë me ndonjë dispozitë në ligj, më shumë me pjesën operative.

ARSIM MORINA: Ashtu është.

KRYESUESJA: Por, në qoftë se keni ndonjë propozim që mendoni që e operacionalizon si çështje ose ndihmon me qenë sa më funksionale, atëherë siç e përmendëm edhe më herët e lëmë një datë të caktuar orientimisht data 5 e muajit të radhës dhe me shikua se si mundet me u integrua, edhe pse këtu përfshihet pastaj edhe numri i inspektorëve dhe aspektet e tjera për të bërë në tërësi.

ARSIM MORINA: Ligji për tërheqjen e inspektorëve komunal ka qenë është miratuar qysh në vitin 2011, është bërë kjo luftë qeveri, ose ministri me komunat. Tash jemi në vitin 2024, kështu që është lehtë me u miratua por më tepër, ne jemi në shërbim të qytetarëve, edhe të punëtorëve të shërbyesve civil duhet me i pa në çfarë rrethana, në çfarë kushte jemi, mundësitë. Përderisa transporti nuk sigurohet, pagat, shpenzimet e udhëtimit nuk paguhen, ushqimit jo, edhe tash edhe ne jemi familjarë duhet me llogaritë me u que e kam orarin në ora 08:00, shkoj për 10-15 minuta aty, nëse më duhet me shkua në regjion unë duhet me u qu në ora 06:00, deri në ora 16:00 me punua në regjion atje mbas regjionit me u kthy në ora 18:00-19:00 me ardh në shtëpi në familje.

Kështu që prapë le të vendosë komisioni, le të vendosë Kuvendi, janë deputetë ata mirëpo unë kisha kërkuar që t'i keni pak parasysh edhe këto pengesat e implementimit.

KRYESUESJA: Po, po ne pastaj do të reflektojmë edhe në këto vërejtjet e juaja edhe në aspektet se qysh mundet me qenë pak më operative. Zotëria pas jush!

ARTAN HOXHA: Përshëndetje, faleminderit për mundësinë, Artan Hoxha sekretar i tregut prej Komunës së Gjakovës.

Kështu ne vërejtjet tona i kemi në paragrafin 2, të nenit 15. Ky paragraf ndër tjera thotë që të gjithë inspektorët transferohen në detyra të tjera brenda numrit të pozitive të lejuara, mirëpo kjo dispozitë nëse mbetet kështu ka një paqartësi, prej faktit se nëse Ministria gjithmonë ka deklaruar se nuk kemi vende të lira në ministri, edhe aty është thirr sepse nuk mundet me i transferua inspektorët e tregut nëpër komuna.

Mirëpo, tash së fundmi ministria ka hapë një konkurse për mbi 20 vende të lira, dhe nëse mbetet kjo dispozitë shumë lehtë atëherë është që ministria me thënë tash ne nuk kemi vende të lira,

sepse ndërkohë është duke u mbush dhe tash është konkursi i hapur, ka qenë edhe para dy muajve. Përderisa ky projektligj ka qenë në procedurë, ministria dy herë ka shpallë konkurs për t'i plotësuar këto pozita. Dhe, nëse plotësohen këto pozita nuk e di çka duam të bëjmë ne inspektorët e tregut nëpër komuna, që do të thotë ministria shumë lehtë thirr dhe thotë nuk kemi vende të lira edhe ju sistemohuni ku të doni nëpër institucionet tuaja që nuk është në rregull, nuk është korrekt sepse ne kemi hy si inspektorë të rregullt, ju kemi nënshtruar procedurave të konkurrimit. Ka inspektorë të tregut nëpër komuna që kanë përvojë 5, 10, 15, 20 edhe më shumë vjeçare që do të thotë janë jashtëzakonisht të përgatitur, madje edhe më shumë të përgatitur se sa inspektorët në Ministri të Tregtisë, ju them me kompetencë, edhe në bazë të raporteve, edhe në bazë të punëve janë gjithçka që dokumentohet.

Prandaj, ne po ndihemi edhe të ofenduar, edhe keq, edhe përkundër faktit se në fund të vitit të kaluar e kemi pas pas kërkesave të shumta tona, kemi pas një takim me ministren që na ka prit, e kemi falënderuar shumë. Me thënë të drejtën ne atë ditë në takim kemi qenë edhe disa kolegë tjerë, jemi nda të kënaqur me ministren, sepse u mundua të paktën në prezencë tonë që me na ofrua mundësi edhe zgjidhje dhe ka treguar gatishmërinë, mirëpo jemi zhgënjyes në ministri, më 19 mars në këtë komision ku ministrja përveç tjerash ka deklaruar se pse ne nuk kemi për detyrë me i sistemua, nuk po e citoj saktë mirëpo është procesverbali i asaj seance. Tash, nëse ministria deklaron që ne nuk kemi pse le të bën komuna zgjidhje për ta nuk e dimë. Për atë punë ne po kërkojmë që ky paragraf të specifikohet shumë thjeshtë, të gjithë inspektorët e tregut që ushtrojnë këto detyra të transferohen, mendoj që përfundon gjithçka.

Procedura ku transferohet, ku del me punua s'e kemi asnjë vërejtje absolut, nuk jemi ata ne që mundemi me qit këso pengesa. Ne thjeshtë po duam të punojmë, ne thjeshtë po duam me vazhdua punën tonë si inspektorë të rregullt qysh e kemi që shumë vite, shumë e thjeshtë është. Ku na sistemon ministria është krejt diçka tjetër, thjeshtë veç mos të lëmë hapësira që mandej mund të interpretohen ndryshe dhe me lënë, me mbet ne as këndeje, as andej. Shkurt e përmblodha, ne mundemi prapë e dërgojmë edhe me shkrim më qartë, jemi të gatshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti Artan, çështja që ju ngritët është çështje edhe për neve aktualisht, ne veçse si në kuadër edhe të grupit punues do ta shqyrtojmë, se padyshim që është një pikë e cila kërkon të reflektohet mbi të.

Në kuadër të grupit punues vazhdimisht puna e komisionit përcillet edhe me përfaqësues që janë nga ministria, për të kuptuar pak edhe se qysh është menduar edhe nga ana e tyre, mirëpo sot prezentë gjithashtu e kemi edhe Departamentin Ligjor të MINT-it, të cilët domethënë pasi të marrim disa komente prej juve, u kalojmë fjalën edhe atyre për të parë dhe arsyetimin ose se si është menduar kjo dispozitë që është përfshirë në ligj, mirëpo pa dyshim që duhet të jetë pjesë

edhe e diskutimeve tona sepse është tashmë edhe çështje edhe për neve, se e vlerësojmë që duhet me shikua.

Dikush tjetër që dëshiron me marrë fjalën?

BLERIM HYSENI: Blerim Hyseni, Komuna e Mitrovicës.

Sa për informatë, po kam qef vetëm të kemi një informatë të themelimit apo historikut të inspektorateve të tregut nëpër komuna. Inspektoratet në komuna janë formuar prej vitit 2001 deri 2003, ashtu është një histori. 2005 del Ligji mbi Inspektoratin e Tregut nga Kuvendi i Kosovës, ku caktohen dy shkalltësi, domethënë dy shkallë: shkalla e parë dhe shkalla e dytë.

Shkalla e parë kanë qenë inspektorët komunal, shkalla e dytë kanë qenë themelimi apo inspektorët e nivelit qendror pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Deri në 2010 ka bashkëpunuar edhe kanë funksionalizuar shkëlqyeshëm punët të cilat kemi pas probleme, kemi bashkëpunuar me inspektoratin qendror dhe i kemi eliminuar të gjitha parregullsitë domethënë të hasura në teren. Në 2010 fillon ligji i ri mbi inspektoratin për mbikëqyrjen e tregut pranë Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë. Aty në nenin 35 nëse s'gaboju parashihet që të gjithë inspektorët nëpër komuna barten automatikisht në nivelin e inspektoratit qendror.

Pat probleme për bartjen e buxhetit atëherë me ndërmjetësimin e asociacionit të komunave dhe nënshkrimin të memorandumit në mes të Ministrisë së Tregtisë së atëhershme dhe kryetarëve të komunës formohen zyrat e Inspektoratit të Tregut nëpër komuna. Raportimi i punëve të Inspektoratit ka shkuar në dy nivele: vertikal dhe horizontal. Bashkëpunimi ka qenë i shkëlqyeshëm.

Më vonë, vjen edhe një vendim nga kryeministri në vitin 2013, ku thotë inspektorët e tregut transferohen automatikisht në nivelin qendror, e cila s'ka ndodh kurrë. Por, punët, autorizimet, përgjegjësia dhe kompetencat kanë vazhduar nëpër inspektorate komunale. Deri më tani nuk kemi pas problem. Ne deri më tani kemi qenë zyra e Inspektoratit të Tregut pranë komunave në bazë të memorandumit.

Ne e kemi konsideruar veten si inspektorë të nivelit qendror edhe pse kemi funksionalizua nëpër zyrat komunale. Ne jemi të brengosur me nenin 15, çka do të bëhet me neve?! A do të ketë mundësi bartja? Apo s'do të ketë mundësi bartja? Ne duhet me i njoftua edhe inspektorët se me padurim po presin çka do të ndodh me ta. Ne kërkojmë vetëm një përgjigje çka do të bëhet me fatin tonë.

Unë mendoj që buxheti nuk do të jetë problem, sepse para një kohe të shkurtë inspektorët e pylltarisë e të tregut, tash po shkojmë edhe agjencia krejt po barten në nivelin qendror, po barten edhe me buxhet. Po, nuk e di përgjigja ka qenë që buxheti është problem, po ne nuk po e shohim

edhe fort problematike këtë çështje, tek e fundit ne mundemi vetë me vazhdua me funksionalizimin nëpër zyrat komunale dhe s'kishte me qenë problem. Kaq, faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Blerim! Siç e përmenda edhe më herët kjo është përpara se që komisioni të mbledhet dhe të shqyrtojë nen për nen ligjin, kështu që ne s'jemi në gjendje aktualisht të japim një përgjigje sepse edhe neve na duhet me trajtua. E trajtojmë prej shumë këndvështrimeve, shpeshherë ka dhe ekspertë ose dikë që angazhojnë për me jep më shumë qartësi, kështu që kjo do të jetë pastaj pjesë e punës, mirëpo ne jemi vazhdimisht të hapur edhe qoftë edhe për takime edhe për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Por, është çështje edhe për neve, kështu që do të merr vëmendjen e nevojshme. Deputeti Lekaj!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesuese e grupit!

Të nderuar të pranishëm,

Sa i përket çështjeve që i theksuat janë të drejta, sepse ligjet bëhen për tu implementuar, për qytetarët dhe për t'i thjeshtësuar mekanizmat e veprimit.

Ajo që mund të them është që kemi pas keqkuptime sa i përket inspektorit të tregut apo inspektorëve të tregut nëpër komuna edhe në raportim, edhe në veprime, edhe lidhja që e thatë horizontale dhe vertikale. Është e vërtetë që jemi mbledh asociacioni i komunave dhe e kemi pas kundërshtuar ligjin në vitin 2010, sepse nuk u përcaktonte saktësisht se çka do të bëhet sa i përket inspektorëve komunal.

Dhe, unë plotësisht pajtoj me juve që ndoshta mirë kishte me qenë që inspektorët komunal të garantohen që edhe nëse bëhet transferi ta kenë punën e sigurt, edhe e thatë me të drejtë paragrafi 2, i nenit 15, që duhet të ndryshohet që mos t'i lë në mëshirë e fatit të gjithë ata inspektorë të tregut nëpër komuna dhe unë do të lloj në këtë drejtim.

Nuk e di a do ta kemi votën, sepse është mazhoranca ajo që vendosë, ne jemi në demokraci, por unë fuqishëm do të lloj që tua thjeshtësojmë punën e veprimit, por edhe të ua sigurojmë vendin e punës. Nuk e di, e përmendët ministren, ministrja nuk po dua të bëj politikë sepse ligjet nuk duhet të politizohen, fjalët i ka të ëmbla por punën askund.

Dhe, nuk është mirë që dikush kur të ju premtan diçka e sidomos kreu i lartë i ministrisë që është ministrja apo mundet me qenë dikush tjetër, që të ju thotë diçka tjetër, a të veprojë diçka tjetër. Sepse, duhet me qenë njeri, me u nis nga vetja nëse çka do të kishte me bë ajo ministre, apo unë, apo kushdo tjetër nëse jemi në pozitën e njëjtë. Nuk është puna vetëm e pagës, por veç ta përfundoj, unë po e përfundoj mos mu përziej të lutem, të lutem, shumë po ju djeg për ministra, e kam të drejtën time.

Ti pse je kryesuese ti s'mundesh me ma ndalë fjalën. Po në komision se ka të bëjë me ligjin, sponsorizues është Ministria e Tregtisë, prandaj mos mu përziej të lutem. Po ti s'mundesh, të lutem, shumë je interesant. Do të thotë, këtu jemi të barabartë, pse udhëheqë ti... ministrja është sponsoruese e ligjit, prandaj nuk e di çka ki. Çka ju djegë si të përmendet dikush i qeverisë, a i ministrisë a, thu ti që jeni avokatë të saj. Unë po them, duhet me qenë përgjegjësi e çdokujt, e çdo niveli kur të komunikojë me masën, me juve, për ta implementuar ligjin me përpikëri që është i implementueshëm dhe që ua siguron, edhe i zbatueshëm, por që ua siguron edhe ju vendin e punës, sepse nuk qitën në rrugë gjithë këta inspektorë. Këtë po e them, dhe unë do të jem lobues në këtë drejtim që paragrafi 2, neni 15 të ndryshohet edhe të shikohet sa i përket edhe ristrukturimit komplet të zyrave apo delegimit të autoriteteve me regjione të caktuara. Këtë po e them.

KRYESUESJA: Po sa herë që e vlerësoj që është e nevojshme padyshim që përzihem se unë e kryesoj. Deputete, fjala për ju!

VALENTINA BUNJAKU REXHEPI: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje për gjithë ju të pranishëm,

Kolegë deputetë,

Dhe, ju nga ministria,

Ne këtu bëjmë debate, po interesimi jonë është që të jetë një ligj funksional dhe i zbatueshëm realisht.

E tha kryesuesja me të drejtë që në këtë ligj absolutisht, edhe ligjet tjera, të cilat janë në të mirë të qytetarëve, në këtë rast të inspektorëve nuk dua të bëj politikë, por politikë tjera herë, në tjera raste. Në këtë rast jemi më se të interesuar që ky ligj të jetë i zbatueshëm dhe të jetë funksional. Normalisht, që ky neni që e përmendët ju, ne do ta shqyrtojmë e ta analizojmë dhe gjithçka që është e mundur, do ta përmirësojmë me vërejtjet e juaja dhe besoj që, edhe kolegët e pozitës, edhe të opozitës, janë të interesuar që të zgjidhet kjo problematikë, domethënë ky neni 15, paragrafi 2.

Kështu që, ne i morëm komentet e juaja dhe në grup punues do ta shqyrtojmë amendament për amendamenti dhe do ta bëjmë më të mirën që është e mundur.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete!

Ju veçse keni marrë hapa për ta ngritur edhe në çështje të diskutimeve, të cilat i kemi pasur në komision dhe besoj që do të keni rastin pastaj të reflektoni edhe në propozimet që vijnë, qofshin nga deputetë, qofshin edhe nga palë të jashtme.

Për fund, po ua kalojmë fjalën juve. Merrni reflektim edhe prej këndit tuaj.

SELVIJE ÇEKU: Jam Selvije Çeku. Jam udhëheqëse për hartim të legjislacionit në Ministrinë e Tregtisë.

Sa i përket këtij projektligji mendoj se është kryesisht i harmonizuar me Ligjin për inspektimet dhe mendoj se është në rregull, përpos normalisht dispozitës. Atë dispozitë do të mundohemi ta shqyrtojmë edhe në grup punues, me e marrë më të mirën të mundshme, se edhe ne nuk kemi mendua me i lënë inspektorët pa punë dhe me i largua. Nuk e di për këtë arsyetim, domethënë për nenin 15, paragrafin 2, kemi opinion edhe prej Ministrisë së Financave. Këtë mundet me e arsyetua më mirë edhe kryesuesi, mirëpo do të mundohem më të mirën e mundshme që edhe në grup punues këtu parlamentar me e analizua.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja e ka një pyetje.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Konkretisht. Domethënë, ne e kemi pasur njëfarë debati, po mendoj herën e kaluar kur ka qenë edhe ministrja. Unë e di që nuk ka qenë me qëllim të keq, e di që inspektorët s'mundeni me i lënë pa punë, sepse ekzistojnë organet që jua kthejnë ndoshta në punë njerëzit që janë pranuar me konkurs.

Por, unë konkretisht po më intereson, a lihen inspektorët në fatin e komunave, apo do ta bëni një zgjidhje si ministri dhe cila është ajo zgjidhje, të cilën ju e keni paraparë në këtë rast, si zyrë ligjore e pata fjalën? Mandej, normalisht që thash po e përsëris ky ligj vjen te ne deputetë që kemi me e analizua amendament për amendamenti, po ju si zyrë qysh e keni...?

SELVIJE ÇEKU: Faktikisht, këtë pjesë ndoshta po them më mirë e arsyeton kryesuesi i grupit, meqenëse ka marrë pjesë prej fillimit në këtë projektligj. Si zyrë ligjore nuk është që e kemi hartuar.

NAIM HAJRA: E para, drafti fillestar i projektligjit, kur ne e kemi proceduar fillimisht, ka paraparë që Inspektorati i Tregut me u rregullua në dy nivele pak a shumë, domethënë në nivel qendror dhe në regjione, me idenë që me u përfshi të gjithë inspektorët, thjesht me u organizua nëpër regjione. Meqë, kemi marrë praktika, edhe nga shtetet tjera, edhe nga ekspertët, të cilët na kanë sugjeruar që një organizim i tillë mund të jetë funksional në Kosovë, po pastaj këtë çështje e ka problematizuar një interpretim që Ministria e Financave e ka dhënë në raport me mundësinë e bartjes së buxhetit.

Ata na kanë thënë që ju mundeni me i marrë inspektorët prej komunave, me i bë inspektorë të ministrisë, po nuk mundeni me e marrë buxhetin e komunave dhe me e delegua në ministri. Edhe, kjo pastaj e ka problematizuar, unë e kam këtu interpretimin e Ministrisë së Financave, dhe si rezultat i këtij interpretimi pastaj ne kemi ardhur në atë pozicion që është dashur me e ritrajtua këtë çështje dhe është bërë një model siç është aktualisht.

Domethënë, absolutisht nuk ka qenë indicie për me e lënë ndonjë inspektor pa punë, në asnjë variant këtu nuk flitet që me shua vende të punës. Domethënë, autorizimin e një inspektori komunal që ai me e mbikëqyrë tregun në pikëpamje të legjislacionit që ne e kemi, e kemi larguar prej tij, por vendi i punës i tij si inspektor mbetet, padyshim që mbetet në kuadër të komunës, thjesht me autorizime tjera me e mbikëqyrë domethënë rregulloret dhe aktet e komunës. Po, pastaj mbikëqyrja... inspektorët në secilin variant do të kenë mundësinë, edhe tash në procedurat e rekrutimit që janë duke ndodhur në ministri, sepse e thanë ata e kanë përparësinë edhe të përvojës së punës, edhe të eksperiencës e ekspertizës që e kanë.

Domethënë, absolutisht nuk i përjashton. Thjesht, organizimi aktual, me organizua në nivel qendror, është si pasojë e një interpretimi që neve na është thënë nuk mundeni me e marrë buxhetin e komunës. Edhe në qoftë se, i kishim marrë ne gjashtëdhjetë inspektorë, interpretimi na thotë që ai ka qenë një barrë financiare shtesë disa milionëshe për ministrinë, kjo pastaj e ka imponua këtë rregullim që ne e kemi aktualisht në këtë projektligj.

KRYESUESJA: A patët ju diçka?

ARSIM MORINA: Ti Naim, më duket që tha se kompetencat, me i marrë kompetencat përmes ministrisë dhe qëndrimin me e pas inspektorët komunal, në zyrat komunale ku kemi qenë, a tha kështu diçka? Kompetenca...

(Diskutim pa mikrofon, nuk mund të transkribohet)

ARSIM MORINA: Po! Po qëndrimi ynë ku me mbete?

(Diskutim pa mikrofon, nuk mund të transkribohet)

ARSIM MORINA: Për atë, se ky kolegu që tha më herët aty, kur a mbajt qaty diku në 2010 - 2012, që tha në zyrat komunale, inspektorat, po memorandum, kryetari aktual atëherë na patë thënë këtu asnjë minutë s' du me të pa, shko kah të duash. Mirëpo, ra që tha u shfuqizua qetu por prapë duhet me pas ne kujdes me u definua saktë ku qëndrojmë ne? Nëse ne veç kompetencat, me i marr kompetencat në komunal, e ne qëndrimin me na e lënë prapë aty unë shpresoj dhe mendoj që shumë kryetarë kanë me reagua që nuk kanë me na lënë me qëndrua për shembull nëpër zyrat komunale dhe kjo është për neve shqetësuese.

PAL LEKAJ: Sa u përket strukturave kombinuere që mund të jenë praktika, që mendoj nuk kanë qenë funksionale dhe të implementueshme, sepse Ligji për qeverisje lokale që është bazë e funksionimit të një komune ua jep të drejtat komunave që ata të vendosin sa u përket strukturës komunale, qoftë vertikale, qoftë horizontale.

Dhe, këtë nëse ne nuk e saktësojmë saktë kompetencën e Inspektoratit Qendror dhe e përziejme dhe e lëmë vetëm me një memorandum të mirëkuptimit me komunat, s'kemi bërë asgjë. Sepse, asnjë kryetar i komunës, asnjë komunë, nuk e merr përgjegjësinë derisa nuk është kompetencë dhe nuk i përgjigjet drejtpërdrejtë departamentit, drejtorisë, apo kryetarit.

Kështu që, e bëjmë prapë mish-mash. Po e them, ne duhet të jemi të qartë, t'i përcaktojmë detyrat. Sa u përket vijave buxhetore, keni të drejtë kur e thoni se kryetarët e komunave nuk duan me u dëmtua me vija buxhetore dhe me bartë inspektoratin me vija buxhetore. Këtë mund ta saktësojmë me ligj, që e obligon, ligji është mbi ministrat, Qeverinë, e të gjithë. Në bazë të ligjit duhet të funksionojmë dhe ne mund ta saktësojmë saktë, se të gjithë obligohen, departamentet, Qeveria, obligohet që gjithë Inspektoratin komunal të tregut ta transferojë me vijë buxhetore, me inspektoratin qendror të tregut.

Tani, me udhëzime administrative, që dalin pas miratimit të ligjit, mund të delegohen zyra përkatëse në regjione të caktuara. E delegon autoritetin tënd në zyra regjionale dhe kjo është shumë e thjeshtë, e implementueshme dhe funksionale. S' di a pajtoheni. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputete Valentina.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Përgjigja nga ministria, sinqerisht po ju lus kështu si përfaqësues të ministrisë, specifikoni mirë, bisedoni me ekspertët e juaj atje, në qoftë se mbetet ky paragraf kështu, jo i bie që inspektorët komunalë mbeten në fatin e kryetarëve të komunave, ku po duan dhe ku s'po duan me i sistemua. Një kryetar i komunës e çon një inspektor në sportel të punojë aty te shërbimet publike, për shembull, e me i pranua dokumentet. Dhe, kjo përnjëmend nuk është njerëzore dhe nuk jam kundër shpalljes së vendeve të punës për inspektorët, dhashtë zoti edhe më shumë bile shpallni vende, sepse ne kemi nevojë për me hy në punë qytetarët tanë dhe njerëzit që kanë kryer fakultete e janë të kualifikuar, por mos e jani ju si ministri me na krijua neve konfuzitete e përçarje në mes deputetëve, sepse krejt deputetët e kanë interesimin me u zgjidhë ky problem.

Në qoftë se, reagojnë kryetarët e komunave, se ka pas rast kur e di kanë reaguar edhe kryetarët e komunave, se s'kanë dashur me ju bartë buxheti, neve nuk na intereson. Deputetët janë, edhe mbi pozitën e kryetarëve të komunave, edhe mbi ministrinë, në këtë rast deputetët vendosin. Por ne, unë, si deputete, si përfaqësuese e LDK-së, kam thënë publikisht, në qoftë se ky amendament rregullohet, gjithë LDK-ja kanë me marrë pjesë në votim dhe kanë me e votua këtë ligj, sepse është në të mirë të qytetarëve.

Po, në qoftë se vini ju si ministri dhe na thoni, ka thënë ministri kështu, ka thënë kryetari i komunës kështu, dhe inspektorët do të mbeten në mëshirën e kryetarëve të komunave, se shumë

mirë thotë këtu ky neni, domethënë neni 15 shumë mirë thotë, s'po dua me e lexua, domethënë nëpunësit në qoftë se kanë mundësi me i sistemua kryetarët e komunave. Po, kjo si ministri është e papranueshme. Kur ne si grup punues normalisht që kemi me e bë punën tonë, po edhe ju si ministri është mirë me e dhënë propozimin konkret.

Neve nuk na intereson ministri i Financave a po thotë që duhet me e bartë buxhetin, a po mundet, a s'po mundet, kjo është punë që duhet me u zgjidhë njëherë e përgjithmonë dhe nuk mundet inspektorët komunalë me mbet në fatin e kryetarëve të komunës, a po i sistemon në nivel qendror, a po i lë në nivel lokal. Le të zgjidhet kjo njëherë e përgjithmonë për të gjitha gjeneratat e ardhshme.

Kështu që, edhe ju si ministri bjerna një propozim konkret, ju kisha lut, se edhe herën e kaluar ministrja, jo do të mbesin, jo s'do të mbesin, jo po shkoj po flas aty... Ajo nuk e ka pas atë ide, sepse asnjë ministër nuk është shumë ekspert ndoshta për qatë pjesë, po ju si zyrë ligjore, ekspertë në ministri, ejani me propozime konkrete.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Ia kalojmë edhe deputetes Kusari.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesuese!

Përhëndetje për të gjithë të pranishmit!

Mendoj që kompleksiteti i këtij neni dhe i pozitave të inspektorëve është, edhe në aspektin funksional, edhe në aspektin politik dhe në aspektin e komunikimit të nivelit lokal dhe qendror.

Unë e kuptoj arsyetimin e ministrisë së financave kur thotë që s'mundet me i transferua pozicionet, gjegjësisht buxhetet prej komunave te ministria, për arsye se e dimë se si është reagimi, menjëherë asociacioni i komunave, politizohet çështja, thotë po na merrni pozitën, këto janë pozita të nivelit komunal, edhe hyn, bie në gërrshërë të politikës.

Në aspektin funksional, gjithashtu jam e vetëdijshme që ka pasur inspektorë që në momentin kur janë të angazhuar dhe të... gjegjësisht kur kanë kontratë me komunën, në momentin kur çon ministria kërkesë për inspektime thotë, po pse me i çua ne ministres raport e në veçanti kur ka dallime politike e këto po janë të shumta. Fatkeqësisht, vuan sektori, vuan mbikëqyrja e tregut, si rrjedhojë e dallimeve politike që ekzistojnë.

Në fund, tash në aspektin njerëzor dhe institucional, tash inspektorët aktualisht ata që duan t'i përkushtohen punës së vet, mbeten në gërrshërë midis dualizmave, edhe institucionalë, edhe politikë. Tash, unë mendoj që këtu definitivisht duhet një ridefinim i këtij neni, në të cilin përcaktohen qartë kriteret për angazhim të inspektorëve të nivelit qendror në mbikëqyrje të tregut, të cilët do të jenë në kompetencë të ministrisë, po me të cilët pastaj ka dakordim edhe nga niveli komunal.

Do të thotë, në këtë rast në momentin e shqyrtimit propozoj, kryesuese, që të ketë edhe përfaqësues, të ftohen përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës në takimin e radhës, të prezantohet dhe t'u dërgohet propozimi i amendamentit të ri, në të cilin komunat të gjitha në Kosovë, 38 prej tyre, duhet të dakordohen që në kriteret të cilat përcaktohen, ose ridefinohen me këtë nen, ministria bën vlerësimin e punëve aktualisht që janë të inspektorëve komunalë, që janë të angazhuar prej komunës, por të cilët domethënë kanë dhënë raporte edhe në ministri, dhe pastaj ata angazhohen, ose ridefinohet pozicioni i tyre si të angazhuar në nivel të ministrisë, ndërsa të tjerët që dëshiron, ose numrin tjetër që dëshiron ta mbajë komuna, i mban, se është e vërtetë, komuna mundet me pas nevojë për shërbime të veta të mbikëqyrjes në nivelin lokal për çfarëdo qofshin ato.

Por, nuk mundemi në formë arbitrare, as ne si Kuvend, as ministria, por as komuna, me e pru vendimin final. Kjo duhet me u bë me një bashkëpunim, nëse ekziston vullneti. Se, në fund të ditës, centralizimi i Inspektoratit ka qenë projekt me Bankën Botërore që disa qeveri, mundeni me e pyet edhe kryeministrat paraprakë, gjithmonë ka qenë rekomandim që mbikëqyrja e tregut ka me funksionua kur të ekzistojë një strukturë vertikale.

Domethënë, nuk është çështje politike, se unë e di që ka pas tendencë me u politizua, jo ju po doni me i marrë krejt, kjo ka qenë rekomandim me vite e vite të tëra, që thuhet se tregu ka me funksionua mirëfilli, nëse në nivel të Kosovës ekziston një standard dhe ai standard po synohet me u krijua. Po tash, në këtë të njëjtën frymë duhet me qenë të gjithë. Domethënë, nëse nesër një inspektor i komunës së Malishevës i vjen kërkesa me shkua dhe me e bë mbikëqyrje të tregut në komunën e Pejës, nuk ka ai me thënë, jo tash mua më ka marrë në punë kryetari i Malishevës edhe unë nuk shkoj.

E atëherë, duhet me ekzistua qartazi, edhe kompetencat, edhe vija e raportimit, por edhe mbrapa raporti kthyes, për arsye se pak instruktorë të tregut, të jemi të sigurtë, në nivelin komunal kanë dërguar raporte në ministri. Dhe, kjo është lehtë e verifikueshme, se ato janë dokumente zyrtare dhe mundet me u pa se sa raporte mundet ministria me na ofrua neve atë informacion, sa raporte... *(Ndërprerje, diskutim pa mikrofon)* e tash, në këtë aspekt duhet me e marrë konfirmimin nga 38 kryetarë të komunave, po tash.. ose... se nuk... Valentina, nuk ka formë tjetër, përveçse nëse dihet qartazi, nuk funksionon kjo me vullnet të lirë, as të ministres, as të kryetarit, as të inspektorit. Qartësisht... po, me ligj e rregullojmë, por duhet me u sigurua, njëjtë sikur ka reaguari Ministria e Financave, që ka thënë s'mundemi me ia marrë...

(Ndërprerje, diskutim pa mikrofon)

Ama kjo... po, po, po tash ne duhet... Kjo është çka po them unë, kryetarit të Malishevës, kryetarit të Pejës, kryetarit të Mitrovicës, të cilësdo komunë, s'është me rëndësi, duhet me iu bë e

qartë, që në momentin e përcaktimit, ridefinimit me këtë ligj, të pozicionit të Inspektoratit të Tregut, ata raportojnë drejtpërdrejtë në ministri. Edhe që e kanë lokacionin, ose nëse duan me e pas një dispozitë kalimtare, që deri në buxhetin e vitit 2024 të mbesin me komunën, prej vitit 2025 kalojnë me ministri, po duhet të jetë e qartësuar në mënyrë që të funksionojë.

Po them edhe një herë, ne duhet me e heq dhe përfundimisht me e shikua këtë si një funksionim të mirëfilltë të mbikëqyrjes së tregut, nëse shkojmë në konotacionin politik, me ia dhënë kush është sot kryetar i komunës, ose kush është sot në Ministri të Tregtisë, e kemi humbur lojën prej fillimit, ose e kemi humbur komplet konceptin. Këtë mundemi me e kthye mbarë vetëm nëse e shikojmë.

Mbikëqyrja e tregut është proces i centralizuar, për arsye se është rekomandim, e tha Lumja, që 12 vjet unë e di që Banka Botërore merret me këtë çështje dhe thotë duhet me ekzistua një agjenci dhe një mbikëqyrje. Mandej, Kosova në tërësi është territor i vogël. Me i pas pesëmbëdhjetë standarde të mbikëqyrjes së tregut nuk shkon. Duhet me qenë një standard dhe duhet me ekzistua një organ që e bën mbikëqyrjen.

Tjetra është, që gjithashtu tek ne në komunitete të vogla është vlerësuar që familjarizimi i inspektorit me operatorët ekonomikë nuk sjellë shumë vlerë, se sadokudo njihen, e din, nuk e aplikon standardin e njëjtë, ekzistojnë pastaj forma të tjera, mos të hyjmë tash në ato animet që munden me ekzistua. Prandaj, lëvizja e inspektorëve ka kuptim, domethënë për inspektime të caktuara dhe kjo duhet të jetë standard, në të cilin mandej kur fillon zbatimi i saj nuk ka ridefinim, ose ri rezistencë prej nivelit lokal, por ekziston një vijë e...

Po, inspektorët sanitarë kanë qenë edhe më herët në nivelin... a kanë qenë në Ministri të Shëndetësisë? Eh! Po tash, duhet me dispozitë kalimtare ndoshta me i bërë që në nivelin qendror, domethënë niveli lokal funksionon deri në fund të vitit 2024, prej 2025-ës kalojnë në ministri.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: A me dhe fjalën? Po, e kuptova.

Në qoftë se për shembull, pse ne si deputetë nuk e bëjmë për shembull të gjithë inspektorët me kalua në kuadër të ministrisë, pikë. Tash, në qoftë se këtë vit nuk ka buxhet, mundemi prej 2025-ës ata me u planifikua... po, mirë, mirë, por mundet.. çka sipas performancës, sipas raporteve, nuk mundemi tash me i vlerësua inspektorët sipas raportit që i kanë dorëzua, apo performancës që e kanë, sepse kryetarët e komunave nuk i kanë lejuar të bashkëpunojnë me nivelin qendror e nuk domethënë një inspektor me u dënua në atë aspektin, me mbet në kuadër, apo në mëshirën e kryetarit të komunës për me e sistemua dikund, për shkak se s'ka dorëzua raporte. Kur kemi kryetarë komunash, që për shembull, i ka thënë jo, ti je inspektor i jemi, çka ke punë ti me ministri? Edhe, nuk domethënë tash me pësua inspektori në këtë rast. Këtë desha të them.

Kështu që, unë pajtohem me të gjitha propozimet e tua.

KRYESUESJA: Besoj që është veç... prite radhën, të lutem, përmbaju. Të përmbahemi pak! Unë po e shoh që ekziston njëfarë paqartësie edhe në raport me institucionet, edhe në raport me inspektorët, kompetencat e tyre, sistemimin e tyre dhe bazës ligjore.

Tash, ju besoj i morët edhe disa ... A mundesh, të lutem, veç ta përmyll e pastaj ua japim fjalën. Ta bëjmë njëfarë rendi, a! Të lutem!

Edhe, besoj që deri në takimin e radhës, që e kemi edhe si grup punues, me të cilët do të jeni të ftuar edhe ju, me i mendua pak disa opsione alternative, të cilat mundeni me ia propozua edhe komisionit, e pastaj edhe ne bashkërisht i japim inputet, mirëpo shfrytëzoheni këtë kohë që në kuadër të këtyre komenteve që po i merrni, me reflektua në potencialisht dy-tri alternativa që mundeni me qenë edhe praktike edhe operative edhe i qartësojnë këto paqartësi, qofshin ato institucionale, qofshin kompetencat e tyre, qofshin edhe në këtë qëllimin e përbashkët tonin që nuk është që me ia rrezikua kurrkujt vendin e punës, po qysh me e bë një strukturë pak më operative dhe këto dualizma që ekzistojnë t'i kalojmë. Saliu e ka kërkuar fjalën.

SALIH ZYBA: Faleminderit kryesuese!

Së pari, me kolegët që janë këtu prej nivelit të komunave, me këso mundësie të debatohet përse unë kam përvojë në të kaluarën, nuk keni pasur mundësi të jepni kontributin.

Ne po e vlerësojmë prezencën dhe kontributin tuaj, pavarësisht se për përshtypjen time është shumë e orientuar vetëm te pozicioni bukur personal. mundësia për të ardhur te përfundimi që e dha edhe një afat kryesuesi, është shumë më mirë. që ju të mos dukeni avokatë të vetvetes, po të ideve se si është më mirë.

Referuar përshkrimit të Blerimit prej Mitrovicës ishte përshkrimi prej pasluftës qysh është mbajtur edhe evidenca, 2005 që ka pasur me dy shtyllat, ishte 2010 si ligji me ato ndryshimet. Për diçka që mbete borxh, kur the: vendimi i Kryeministrit i vitit 2013 nuk është zbatuar. Kjo nënkupton, për të mos ardhur te vendimet arbitrare, të paarsyeshme a të pafuqishme, është kjo nuancë në këtë ligj.

Meqenëse një draft e kanë sjellë, nuk është përfundimtar, por është draft a ide i një mekanizmi që pretendon ta ketë kontrollin mbi këtë fushë. Kjo, nëse e lexojmë titullin, i kthehem këtij drafti. Tash, këtu është diskutuar, po disa jemi për herë të parë.

Ky projektligj është për nivelin qendror. D.m.th. një kompetencë po e definojnë për nivelin qendror. Pra, nuk ka të bëjë me nivelin komunal. Ndërsa halli deri tash ishte për pozitë individuale atje. Unë e di pak a shumë, që cilado prej qendrave, jo Ministria, po ne si komision ia adresojmë një çështje nivelit komunal për një kërkesë për inspektim, po ja po jam më konkret, në

shumicën e rasteve, cila është përgjigjja e komunave. Nuk kemi inspektorë të tregut, nuk kemi fuqi, nuk kemi kompetencë, deri te nuk kemi automjet. A janë përgjigjet e tyre këto? Praktike, funksionale? Mirë!

Po e them në përgjithësi. Ne mund edhe të sfidohejmë, po këtu nuk jemi për t'u sfiduar. Jemi për të dhënë ide. Ideja ime është kjo, të ndryshohet, të nxirret gjendja e mjerimit që e kemi në komuna sa i përket shërbimit për tregut. Një prej fushave që më lëndon më shumë në Kosovë, është tregu, gjendja në treg. Ndoshta prej deklarimit të mallit, ose mënyrës qysh vjen në maune e deri te konsumi nga qytetarët.

Ne jemi në komisione të ndryshme, e tregu është çdo formë e funksionimit, qoftë produkt bujqësor, qoftë industrial, kudo. Për këtë po them, duhet parë tregun si gjithçka, e jo pozicion. Aq më pak në atë dallimin ku do të jetë pozicioni i ardhshëm.

Unë po them diçka. Për mua është shumë e rëndësishme përkufizimi i kompetencës. Ato detyra, veç ta kini parasysh, si e tha Mimoza, po e tha shumë shkurt, veç e përmendi, nuk e shpjegoi. Komunitat kanë nevojë për inspektorë. Le të më thotë, cili është i kualifikuar një inspektor tregu. Ai është shërbim, nuk është kualifikim profesional. Këtë mos e harroni. Nuk ka kualifikim: inspektor tregu. Nuk je ti i diplomuar në treg. Këtë përvojë e kemi pasur ne në konkurse kur e kemi shpallur. Unë jam jurist, shumë mirë. komunikacion, mjek...

Prandaj rregullimi duhet të ndodhë me kompetencë. Zyra ligjore, provoje ti qoje ndërtimtarin. Nuk ka nevojë të përmenden emra të përveçëm, se je inspektor tregu. I di edhe do rregulla ku marketingu bëhet ose reklama. Prandaj, duhet parë me profesionalizëm këtë farë pune. Kjo nuk është ndaj teje, po ndaj gjendjes. Ne kemi kompetencë. Tash, mos e merr në personale ti. Unë thashë rregullimi. Kërkesa juaj që veç për pozicionin personal. nuk thashë është interesi personal. u mundova ta bëj dallimin. Ata të gjithë e paskan kuptuar, po më duket u lëndove. Nuk kam qëllim të të lëndoj, e kundërta është.

Po, po, te ligji jemi duke folur. Kjo është nuanca. Po nuk mund ta mbyllësh ti, pa e mbyllur unë. Qysh do ta mbyllësh ti?

KRYESUESJA: Zotëri, deputeti ju priti secilin nga ju derisa e përfunduat fjalën. Të lutem, përmbaju, le ta kryejë fjalën, pastaj.

SALIH ZYBA: Prandaj, po them unë, për mua më së paku, se kjo është e rregullueshme, po ne veç po flasim me kompetencë shtetërore. Nuk po dua të flas. Prandaj po them, e drejta juaj të vini me propozime edhe për pozicione personale. Për mua është shumë e rëndësishme ta definoj.

Komentet janë kështu. Nuk është problem ajo. Kjo është e paraparë, mënyra qysh është e shkruar kompetenca të shkojë me atë shkurtesë atje kush do ta bëjë, e di që është e mundshme, po nuk është e definuar.

Kur e keni draftuar, Mimoza tha nuk ka raportime. Unë po e di këtë gjendje, po nuk kemi listë se sa janë as numerikisht, sa i implikon këta njerëz, sa i ngërthen në vete ky vendim. Unë thashë, shërbimet e tjera të tregut që mbikëqyrjes, që ia merr si kompetencë, neve personalisht kam marrë në mbikëqyrje të Ligjit për pyjet. A e di çfarë ndryshimi ka bërë Ligji për pyjet? Se është rikthyer kompetenca.

Nëse është kthyer në 2010, me decentralizim të shërbimeve atëherë, këtë vit e kemi marrë e ia kemi deleguar nivelit të Ministrisë aty. A e di çfarë ndryshimi ka bërë? Sa i përket pozitive, po i përgjigjem diçka. Aktualisht, e tha dikush që Ministria është duke i plotësuar këto vende. Po, se ka qenë një konkurs... të vetat. Po kjo është kompetencë tjetër. Për pozicionin po flasim. A e keni parasysh? Kur është marrë vendimi që të kalohen kompetencat, komunat e veçanta në momentin që është aprovuar ligji këtu, i kanë shpallur vendet e lira t'i plotësojnë në komuna e t'i çojnë inspektorët në nivel qendror. Edhe kjo mund të na ndodhë. Është edhe e kundërta.

Këtë përvojë e kam paraparë dhe e kemi veçuar. Prandaj, po them, nuk është me rëndësi sa është numri, se numri është i kufizuar. Edhe ne e nxjerrim një pasqyrë, e ndajmë këtë prerje, se po dua ta thjeshtoj pak. këtë prerje e bëjmë apo konstatojmë me gjendjen aktuale. Shumë komuna nuk e kanë të zgjidhur këtë problem. Prandaj, po them të mos flasim për shumicën. Të flasim për këdo, qoftë edhe individ që e thashë, se duhet bërë zgjidhje me ligj. Ligji nuk bëhet veç për shumicën e qytetarëve, apo të bëhet veç për grupet e interesit, po të jetë edhe veç një person.

Prandaj, po them unë duhet paraparë kjo, po nuk jam për të detyruar gjithçka të vijë prej komunave në nivel qendror, sepse ka mundësi të sistemohet, është interes, se u përmend, që interes i tyre është të punojnë në nivel, se u tha nuk ka transport e ushqim. Këto i dimë ne, se ka ligje të tjera që i rregullojnë. Jemi duke u marrë me shërbimin e tregut. Kushdo që do të ndërrojë nivel, ka mundësi me transfere.

Prandaj, po them, sistemimin e pozitive të tregut si inspektorë mund të sistemohen kudo në nivel të inspektorëve, në nivel komunal. Prandaj, nuk e shoh si problem unë, veç t'i bëhet zgjidhja.

Për ndjeshmërinë që e ka, duhet referuar të dhënave aktuale, sa persona i ndikon, sa komunave ua ndryshon gjendjen. Nuk ua ndryshon gjendjen komunave. Për të mos pyetur për raportet ditore, javore e vjetore që e tha edhe Mimoza në komunikim. Se kjo e rregullon, ia jep përgjegjësinë Ministrisë. Deri tash nuk ka qenë si duhet. Inspektorë sanitarë, krejt kemi përvojë, ata e dinë qysh ka qenë. Ka qenë mjerim. Me ato vendimet që thashë të paligjshme.

Prandaj, veç po lutem diçka, nëse do dikush tjetër nuk mund t'ia marrim si të drejtë, po kështu kompetencat unë mendoj që njihen të shkruara. E kush ka propozime deri në atë moment, duhet parë, po duhet të vijë me të dhëna, po jo të më tregojë qysh kryetari i Komunës nuk e dëgjon. Po ti po shpëtoje nëse nuk po të dëgjojka. Pse a mos do të dëgjoj ministrja më shumë? Nuk është argumentim ky. Argumentim është çka ta ndërron ty prej të drejtës së një nënshkrimi që është normë që ke për të vendosur me nënshkrim tënd dhe mbi cilën kompetencë ke për të vepruar. Aty duhet parë veten, jo pozicioni vendi i punës.

KRYESUESJA: Faleminderit Zyba! Zonjë, fjala për ju.

LUMNIJE AJDINI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,
Përfaqësues të Ministrisë,
Inspektorë të shoqërisë civile,
Të gjithë ju.

Lumnije Hajdini nga Aleanca Kosovare e Bizneseve.

Sot me qëllim nuk fola në fillim, për arsye se mandej gjatë diskutimeve në debatet publike të shumë ligjeve e kemi pasur edhe herën e kaluar Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve po ashtu shumë i rëndësishëm që e prek direkt qoftë biznesin si konsumator, qytetarin dhe të gjitha këto.

Sa i përket këtij Projektligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, të themi realisht ne si AKB gjatë gjithë kohës për trembëdhjetë vite, shumë vite jemi munduar me ndihmën e Bankës Botërore dhe USAID që ta bëjmë një inspektorat qendror të mbikëqyrjes të tregut dhe fitosanitar. Kjo do t'i kontribuon inspektimit dhe mbikëqyrjes në të gjitha fushat e ekonomisë.

Sa i përket nenit 14, dispozitat ligjore, unë i kuptoj shumë mirë inspektorët dhe nivelin komunal, sepse asnjëherë nuk ka pasur harmonizim të dy niveleve për shumë mandate. Mirëpo, kur vjen puna te këto ligje, duhet të jenë pozitive e opozitive së bashku, sepse është në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Unë dua të ndalem te një çështje tjetër, dhe kërkoj që të na mundësohet që Ministria e Tregtisë, përpos dispozitave kalimtare, edhe te neni 10 duhet të jetë një qartësim më i mirë. te neni 10, verifikimi i produkteve. Unë do të dërgoj rekomandimet.

p.sh. neni 10, paragrafi 3: inspektori të mos marrë për analizë, e dorëzon pa vonesë te trupa profesionale apo trupat e tjerë kompetente inspektuese nga fusha përkatëse. Ne si Kosovë nuk kemi laborator të certifikuar e akredituar. Ne duhet të kemi të akredituar trupat tona profesionale, që lypset. Në nenet e tjera lypet edhe super-analizë.

Ne si Kosovë nuk i kemi mundësitë. I kemi veç njëzet për qind. Inspektorati Sanitar, Këshilli për Siguri dhe Shëndet në Punë, Inspektorati i Punës. Por, po flas në përgjithësi nuk i kemi. Tash ne duhet për disa sektorë specifikë, unë po ju lus veç për këtë që i ndihmon inspektorëve për të mos pasur probleme, sepse brenda tridhjetë ditësh bëhet inspektimi i një produkti nga ana e bizneseve, edhe duhet të trupat këshilluese të shtetit duhet të jenë të akredituar dhe të certifikuar ndërkombëtarisht. Disa i kemi disa, p.sh. te AVUK këto laboratorët nuk i kemi të certifikuar.

Mandej, dhashtë Zoti që numri i inspektorëve të rritet. Mirëpo, edhe te neni: vlerësimi financiar, të shkohet buxheti. Nuk e di tash sa është planifikuar, po të jetë edhe një buxhet për këto trupat këshilldhënëse që duhet laboratorë, teste e të gjitha këto do të ndikojnë mirë për të pasur mbarëvajtje ky ligj.

KRYESUESJA: Na i dërgoni pra me shkrim se çka mendoni. Do t'ia përcjellim grupit punues. Por, sa më preciz, sa më qartë, në mënyrë që edhe këta ta kenë të qartë, mirëpo edhe ne ta kuptojmë më thellësisht shqetësimin tuaj.

LUMNIJE AJDINI: Ka raste p.sh. kur për një produkt në kufi kërkohet superanalizë. Ajo superanalizë nuk bëhet, edhe këtu vjen puna çfarë produkti po konsumojmë.

KRYESUESJA: Deputeti deshi ta përmbyll.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesuese!

Ajo që u diskutua sot mendoj që do të jetë shumë e rëndësishme për punën tonë për amendamentim të ligjit dhe miratim të ligjit. Çdo ligj përcillet edhe me vija buxhetore që e aprovon së pari Komisioni për Buxhet. në këtë rast, ne nuk guxojmë që të lëmë ligjin që të jetë i kombinuar. Boshllëk në ligjin apo vakum. Duhet saktësisht kompetencë e kujt do të jetë inspektorati.

Nëse e lëmë kështu, mendoj që atëherë me të vërtetë kemi bërë një ligj të politizuar dhe nuk guxojmë që ligjet të jenë të politizuara. Ne dihet kur e kemi kundërshtuar në vitin 2010, kam qenë anëtar i Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe nuk kam pranuar që inspektorët të japin përgjegjësi ministrisë së linjës së veçantë, ndërsa kompetenca e komunave të mbeten me zyra e ato, por të zhveshët nga kompetenca e komunës. Kështu nuk bën.

Duhet të jemi të saktë dhe neni e saktëson, paragrafi 2 i nenit 15 me vija buxhetore dhe ligji vjen e miratohet. Edhe nëse ka shpenzime buxhetore, me dispozita kalimtare i llogarit sa inspektorë janë dhe nëse janë pesëdhjetë a shtatëdhjetë, me vijë buxhetore, thua ligji është i kushtueshëm kaq dhe miratohet me komisionin dhe kjo çështje zgjidhet njëherë e përgjithmonë. Është shumë e thjeshtë.

Më besoni që është shumë e thjeshtë. Neve s'na intereson Ministria e Financave a kushdo tjetër, na intereson ligji të jetë funksional, jo i politizuar dhe veprues. Kjo është. Dhe mendoj që kështu do ta saktësojmë bashkë me juve dhe do ta rregullojmë.

Faleminderit kryesuese që pate durim.

KRYESUESJA: Edhe deputetja...

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Atëherë, unë po kërkoj nga Ministria të na sjellë propozime konkrete dhe të kemi idenë se çka po kërkon deputetët.

Tash, nuk është fjala, kërkesa individuale e kolektive. Është fjala, të zgjidhet problemi njëherë e përgjithmonë të inspektorët, qoftë të komunave, qoftë në nivelin qendror. Kështu që ne jemi këtu deputetë, ligjvënës jemi.

Propozimet tuaja le të vijnë dhe të rregullohet amendamenti në fjalë, sepse nuk është i rregulluar mirë. I hapësirë që inspektorët të mbeten në fatin e kryetarëve të komunës, a do të sistemohen në kuadër të komunës, a do të vijnë në kuadër të Ministrisë. Kështu që, nuk ka mundësi kjo të mbetet ashtu. Ju si Ministri, e dha kryesuesja afatin deri kur të sillen komentet. Dërgoni komentet, e keni idenë se çka po kërkohet qysh të rregullohet ai amendament.

Sa i përket buxhet, mundemi realisht prej vitit. 2025 të planifikohet në buxhet dhe të realizohet kjo. Kështu që, individualisht nuk është fjala, është fjala për t'u zgjidhur dhe për t'u bërë një ligj i mirë dhe i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Unë ju falënderoj për pjesëmarrjen sot.

Atëherë, edhe një herë jua rikujtoj që deri më 5 korrik është afati për të dorëzuar me shkrim propozimet tuaja. Në ndërkohë, shfrytëzoni kohën që të reflektoni pak, pa dashur të dëmtojë nuancën dhe konceptin e ligjit, mirëpo edhe këto aspektet e tjera operative të mundohemi t'i reflektojmë, kështu që t'i sillen edhe komisionit disa prej alternativave, që ne pastaj të mund ti shikojmë dhe ta shohim se çka mund të jetë e përshtatshme edhe për ligjin, mirëpo edhe trupat të cilat pastaj kanë me implementuar. Ne pastaj ju ftojme edhe në takimet e radhës dhe i shohim bashkërisht ato.

Ju faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*